



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 43, datë 12.03.2019

PËR

MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR TË MARRË PJESË NË PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 34, 53, 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 274 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në vendimet nr.17, 18 dhe 19, datë 29.01.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe në propozimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve për Ndihmës Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve për Ndihmës Ligjorë, që **nuk** plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë listën emërore të kandidatëve për Këshilltarë Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë listën emërore të kandidatëve për Këshilltarë Ligjorë, që **nuk** plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE